



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 65

Prishtinë, më 17.4.2012, ora 10,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala në ANEKS

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri.

Mungoi : Daut Haradinaj, Etem Arifi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga MMPH, Asociacioni i Arkitektëve të Kosovës, Asociacioni i Komunave të Kosovës me z. Sazan Ibrahim, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (ICO, KDI, OSBE, Presidenca) dhe media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen (dëgjimin publik) e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Shqyrtimi i Projektligjit për Ndërtimin

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi dëgjimin publik për projektin në fjalë.

Kryetari Nait Hasani në fillim falënderoi pjesëmarrësit duke arsyetuar shkurtimisht arsyen e mbajtjes së dëgjimit publik. Ai fillimisht ju dha fjalën anëtarëve të komisionit për të kaluar ashtu sipas radhës : institucionet etj.

Liburn Aliu gjithashtu falënderoi dhe shtoi se në cilësinë e anëtarit të komisionit (jo në cilësinë e arkitektit) dëshiron të dëgjoj opinionet e pjesëmarrësve të ftuar ngase ky projektligj ka ardhur në Kuvend jo në mënyrë të rregullt me kërkesë të përshpejtuar për përmbylljen e procesit të mbikëqyrjes së pavarësisë, ndaj komisioni medoemos duhet të kalojë procedurën parlamentare që parashihet për shqyrtim. Ai personalisht mendoi se palët e interesuar gjatë draftimit të projektit në MMPH janë anashkaluar, mirëpo ky komision do të mundohet të mbulojë lëshimet e bëra gjatë amendamentimit të projektit. Ai shtoi se ka vërejt një gjë negative, mungesën që ky ligj të hartohet për qytetarin duke vënë interesin e biznesit si kryesore, me një fjalë renditja e

prioriteteve me rastin e këtij ligji, është kthyer përmbys. Megjithatë shpresoi se në këtë komision do të bëhet çdo gjë e mundur për të rregulluar Projektligjin si duhet.

Salih Morina gjithashtu pohoi se çdo gjë që vjen me shpejtësi përcjellët me defekte të caktuara, mirëpo në fund ai shpresoj se do të sjellët një ligj për qytetarin ngase azhurnimi nga dikush nuk do të thotë se ky komision do të ngutet, përkundrazi komisioni do të angazhohet në eliminimin e neneve të dëmshme.

Nijazi Idrizi falënderoi në pjesëmarrje masive dhe pohoi se kjo do të jetë inkurajim për komisionin për një mesazh akceptimi të vërejtjeve nga ky debat publik duke mos treguar me gisht nga njëri tjetri por duke hyrë problemeve themelore të shoqërisë sonë që kanë të bëjnë me ndërtimet. Ai sqaroi se projektligji do të përmirësohet nga ky komision nëse ka nevojë 50%, aq sa lejohet me rregullore, por edhe me mundësi të kthimit të tij. **Nait Hasani** falënderoi dhe kërkoi nga diskutuesit të janë sa më të shkurtë dhe koncizë, ngase pasi që është salla e re pa pajisje teknike, ekziston mundësia e mosinqizimit si duhet të diskutimeve, për çka **Liburn Aliu** kërkoi që diskutuesit të ofrojnë edhe diskutimet me shkrim nëse është e mundur.

Sazan Ibrahim në emër të Asociacionit të Komunave të Kosovës falënderoi për bashkëpunimin dhe ftoi të gjithë nesër të bashkëngjiten ngjashëm në takimin e ftuar nga ky asociacion rreth po të njëjtit temë. Ai ripërsëriti vërejtjet e komunave rreth këtij projekti ngase ndeshet me disa ligje, së pari me Ligjin për vetëqeverisje lokale nenin 17, financat publike lokale, kartën evropiane për vetëqeverisje lokale etj. Ai kërkoi nga kryesuesi që të ftohet nga komisioni ky asociacion ngase në takimet me grupin punues do të shqyrtohen më mirë ndryshimet që propozohen, ngase me ligjin ekzistues janë evidente gjërat që duhet të ndryshohen, taksat për licencime, certifikimi i kushteve urbane, lëshimi i lejes ndërtimore, afatet kohore, ngarkesat buxhetore të komunave etj, janë 12 intervenime që janë përgatitur, përfundoi.

Arben Çitaku falënderoi për bashkëpunimin dhe sqaroi se nga vërejtjet e deritashme ka kuptuar se duhen ca modifikime dhe thjeshtësime të disa procedurave, përndryshe nuk qëndrojnë disa vërejtje, ngase me tri ligje që parasheh MMPH do të eliminohen problemet e cekura deri tani (me këtë ligj, me atë të trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe për Planifikim Hapësinor). Ai ftoi në debat konstruktiv për të miratuar parimet ndërkombëtare në këtë lëmi.

Përfaqësuesi i MT Bajram Limani tha se kemi të bëjmë me një ligj nacional dhe duhet bërë kujdes të jetë edhe i pranueshëm. BE nuk ka direktivë për ndërtimet, ndërsa Brukseli ka një komitet për ndërtime, ndërsa si i tillë ky ligj është i papranueshëm ngase nuk parasheh strukturën e kapitullit 3 të ligjit ekzistues ngase rrezikon ekzistimin e Departamentit për ndërtimin dhe Institutin Kosovar të ndërtimit, nuk është punuar nga njerëz profesionist, nuk shihet qartë çka është kodi unik, objekti ka kërkesa funksionale e jo minimale, tani janë 6+1, nuk parashihet seizmika, zjarret etj. **Gani Berisha** inspektor në MTI u bashkëngjiti me vërejtjen se ky ligj nuk parasheh inspektionin e lartë për ndërtimet. **Gjejlane Hoxha** shprehu kënaqësinë që ky projekt trajton trashëgimin kulturore por megjithatë ka vërejtje të cilat i ka hartuar me shkrim, sidomos tek përkufizimet.

Ilir Gjinolli profesor dhe përfaqësues i asociacionit të planerëve të Kosovës fillimisht pyeti a është ky ligj për leje të ndërtimit apo ligj i ndërtimit, ngase fusha e ndërtimit është shumë kompleks, është ajo që prek tokat bujqësore, regjistrimi në kadastër a duhet të ndodhë dhe si duhet të ndodhë, afati për leje është konfuze dhe në fund është edhe fyese. Reagoi **Arben Çitaku** : duke shtuar “fol për vedi”. Vazhdoi z. Gjinolli : “si mund të ndërtohet sido e kudo pa procedurë transparente, pse tani miratohet koncepti Amerikan i ndërtimit të qyteteve duke lënë atë Gjerman, për neve Amerika është një planet tjetër i jetesës”. Gjuha e ligjit është me shumë gabime, vazhdoi, dhe shtoi se duhet të shtohet mbikëqyrja e ndërtimeve dhe të jetë e obligueshme, kodi unik të dihet e jo të mbetet vetëm duke përmend, cilat taksa të aplikohen.

Ylber Bokshi kryesues i këshillit për planifikim hapësinor tha se është absurde të trajtohet ky ligj para ligjit për planifikim hapësinor ngase PH është bazike, për parimin e heshtjes si pranim dhe nenet 4,18,21 tha se është parim nonsens. Më 2004 ka kontribuar GTZ për ligjin e ndërtimit, ndërsa tani USAID, ndërsa Kosova ka funksionuar edhe para 1999, cili konceptcion tani duhet të miratohet nëse nuk çeket afati për aprovimin e kodit unik, mbikëqyrja neutrale e shtetit duhet të ekzistoi. Në fund sugjeroi se asgjë nuk bëjmë nëse ndërtimet pa leje nuk trajtojmë si penale.

Valdet Osmani në fillim konstatoi në emër të Asociacionit të Arkitektëve të Kosovës se kanë shumë arsye për të kundërshtuar këtë projektligj ngase përmban shumë parregullsi duke filluar nga implikimet financiare, jokategorizimin e objekteve etj. Pas reagimit të kryetarit të komisionit se kanë kohë dy javë të japin vërejtjet me shkrim, ai tha se për secilin nen veç e veç kanë vërejtje, mirëpo me sqarimin e Liburn Aliut u sqarua se nuk mund të hartojnë projektligj të ri, ngase ky projekt që është proceduar duhet të amendamentohet dhe të përfundoj me amendamente të cilat votohen në komision secila. Edhe Salih Morina sugjeroi të dërgohen vërejtjet me shkrim në komision. **Violeta Nushi** arkitekte e pavarur tha se me këtë projektligj mbyllet çdo mundësi për të rregulluar diçka në këtë lëmi, ngase çdo gjë e keqe që dominon tani vulloset me këtë ligj nëse miratohet. **Nebih Zariqi** nga Oda Ekonomike e Kosovës gjithashtu tregoi shqetësimin e tyre në odën ekonomike për këtë ligj dhe kërkoi të përfundoj dërgimi i këtyre projekteve në Kuvendin e Kosovës ende pa shkelur tek ministrinë tjera përkatëse. Ky projektligj në tërësi bënë fjalë për leje të ndërtimit ndërsa shkruan se është Ligj për ndërtimin. **Islam Pacolli** ishte i mendimit se duhet të kthehet ligji ngase hiqet “pashallëku i departamentit të ndërtimit” dhe të parasheh të gjitha institucionet profesionale për leje, taksa. **Valbona Puka** nga Ombudspersoni përkrahu çdo qasje nga Asociacioni i Arkitektëve të Kosovës ngase qyteti i Prishtinës në çdo këndë u shndërrua në kaos të vërtet, fëmijët lozin nëpër garazhe etj , kjo gjendje tanimë prek edhe në shëndetin e qytetarit. **Petrit Selimi** arkitekt i pavarur, inkurajoi për një ligj ku ceket përgjegjësia e plotë ligjore, ngase askush p.sh. për momentin nuk merr përgjegjësi pas një tërmeti që mund të ndodhë, revidimin e projektit (projektuesi duhet të marr këtë përgjegjësi), gjithashtu u angazhua lidhur me mbikëqyrje profesionale për shkak të pasojave ekonomike si dhe të bëhet fjalë për pronën në këtë ligj, ndërsa insistoi që kompanitë e huaja duhet të licencohen sipas ligjeve vendore ngase ato marrin me miliona euro në Kosovë me 0 taksë. Anëtar i Asociacionit të Arkitektëve z. Orhan u fokusua te neni 9 për shkak të konfliktit të interesit ku projektuesi merr pjesë në ndërtim. **Selman Baçohi** nga shoqata e ndërtimtarëve tha se ndërtimtaria si veprim kompleks ka mbetur e pa kontrolluar, në këtë drejtim ky ligj shumë pak do të ndihmoi, duke u nisur nga mosekzistimi i kodit unik e cila u ndërpre dhe nuk dihet pse u ndërpre, e cila u zëvendësua me disa rregulla teknike por pa sqarime se cilat janë ato rregulla (ndërkombëtare apo ato të ish Jugosllavisë), në anën tjetër ndërtimtaria në Kosovë është shkapërderdhur në 4-5 ministri secila për vedi. Ligji për ndërtimin duhet të ndryshoi, mirëpo sipas një renditjeje normale duke filluar me planifikim hapësinor, tokën bujqësore, taksat etj. Në këtë ligj tek neni 1 ceket korniza ligjore ndërsa më vonë te neni 38 shfuqizohen të gjitha ligjet ndërtimore, kush mund të sqaroi këtë. Ai kërkoi bashkëpunimin me ekspertët përkatës dhe studim profesional. **Elez Surdulli** nga sektori i biznesit u fokusua te neni 3 pika 1.22 me të cilin definim eliminohen profesionistët dhe i jepet çdokujt të drejt të jetë projektues, këtu duhet të ketë përgjegjësi e jo p.sh. largim nga vendet e punës, ndërsa **Valdet Osmani** reagoi dhe shtoi se nuk përmendet as regjistri i pronave në këtë projekt, gjë që duhet bërë patjetër ngase prona duhet të rregullohet. **Nebih Zariqi** u fokusua në komunën e Prishtinës ku janë tarifat më të larta ndërsa në anën tjetër asgjë nuk merr nga poseduesi i lejes, dmth cilat obligime i merr komuna për taksën që paguhet përndryshe ajo metrazh mbetet p.sh. pronë e KEK-ut, pra prurja e infrastrukturës duhet të rregullohet. **Kryetari** reagoi dhe tha se normale është ajo gjendje që kryeqyteti të jetë më i shtrenjtë. Profesori z. **Bokshi** në paraqitjen e sërishme tha se të gjithë duhet të kanë eksperiencë në këtë lëmi, ngase ka ndodhur që mbikëqyrësi nuk din çka është tulla, poashtu kërkoi të caktohen afatet për aktet nënligjore te neni 38.8. Për të mos ardhur te ajo gjendje që ky ligj të vërtetoi kaosit ekzistues, diskutuesit në vazhdim sugjeruan sqarime të sakta që duhet të bëhen në ligj duke dhënë përgjegjësi dhe llogari secili që mirët me këtë lëmi. Me kërkesën e disa diskutuesve, **Kryetari Nait Hasani** sërish sqaroi procedurën e amendamentimit të projektligjit, ndërsa **Gjejlane Hoxha** u fokusua në përmbajtjen e ligjit i cili patjetër duhet të mirët me plane të konservimit ngase kjo mungesë do të shkatërroi trashëgimin kulturore të Kosovës, ndërsa për gjë tjetër tha se kush paguan me këtë ligj 1000 euro atij i garantohet mosrënimi i objektit, dmth duhet siguruar që ndonjë objekt patjetër duhet të rrënohet, nëse është nevoja dmth kthimi në gjendjen e mëparshme duhet të parashihet.

Pasi që i dëgjoi vërejtjet, sekretari i MMPH **Arben Çitaku** falënderoi dhe shtoi se duhet të përfshihen edhe ca aspekte tjera përveç atyre që u thanë këtu, siç janë benefitet e përgjithshme, komuniteti i biznesit etj përndryshe shumë gjëra që u kërkuar nga diskutuesit, vazhdoi, janë në fuqi ligjet ekzistuese në bazë të cilave ato realizohen, p.sh. në bazë të ligjit për v. Lokale etj, ndërsa lidhur me “pashallëkun e komunës” ajo eliminohet me këtë ligj, ndërsa komisioni parlamentar bashkërisht mund të diskutoi për afate për ti përcaktuar ato për leje. Ai përsëriti dhe insistoi në argumente të qëndrueshme. Ndërhyri **Ilir Gjinolli** dhe tha “dallaveret duhet të shkojnë në Prokurori”.

Kryetari Nait Hasani falënderoi pjesëmarrësit dhe i ftoi që brenda dy javësh nga sot, të parashtrijnë vërejtjet me shkrim, të cilat do të shqyrtohen nga Komisioni.

Mbledhja përfundoi në orën 12,40

VËREJTJET me shkrim nga disa pjesëmarrës u dorëzuan dhe bashkë me tjerat që do të bashkëngjiten, do të janë material për takimet e komisionit.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani